



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA POGRADEC

NDËRMARRJA E MIRËMBAJTJES SË INFRASTRUKTURAVE DHE PUNËVE PUBLIKE

Pogradec, më 11.04.2024

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMINE SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROKURIMIT: “Mirembajtje Kanali Ujites Leshnice”.**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

*Punime ndërtimi për diga, kanale, kanale të ujitjes dhe ujësjellës 45247000-0*

*Shërbime të pastrimit dhe zbrashjes së kanaleve 90640000-5*

*Shërbime të pastrimit të kanaleve 90641000-2*

**VLERA E FONDIT LIMIT: 2,260,800** (dy milion e dyqind e gjashtëdhjete mijë e tetëqind) **lekë pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Ndërmarrja e Mirëmbajtjes së Infrastrukturave dhe Punëve Publikeka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

**1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3.*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar.

**2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

## 2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

### 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

**2.2.1.** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022 dhe 2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e fondit limit që prokurohet.

*Argumentimi:* Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

*Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:*

*Duke qene lloji i procedure : E hapur e thjeshtuar, percaktimi i vleres se kerkuar eshte bere ne mbeshtetje te nenin 43, pika 2, germa "c" të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ndryshuar.*

*Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë ne mbeshtetje te nenin 43, pika 1 ” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ndryshuar , ku percaktohet se: Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastiit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.*

*Vendosja e ketij kriteri kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor per te vertetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontraten. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar se ky kriter kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor per te vertetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontraten.*

**2.2.2** Operatori ekonomik duhet të ketë paguar **taksat dhe tarifat vendore për vitin 2023 (këstet e maturuara)** për çdo vend të ushtrimit të aktivitetit (sipas QKB), sipas afateve të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë vërtetim për taksat dhe tarifat vendore).

*Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton pagimin e taksave dhe tarifave vendore, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.*

*Argumentimi:* Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 76 pika 2 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar; Kreut V, Seksioni III, Nenin 43, pika 6 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe sipas ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar), ku në zbatim të legjislacionit në fuqi, Qendra Kombëtare e Biznesit ka funksion të mbajë regjistrin tregtar dhe për qëllim të regjistrimit fiskal, në të cilin përcaktohen dhe vendet e ushtrimit të operatorëve ekonomikë, duke qënë se këto të fundit kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i

*kanë likujduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore.*

**2.2.3** Operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit (**2021, 2022, 2023**), të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre. Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në 2 (dy) bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.*

*Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nenligjore në zbatim të tij.*

## **2.3 Kapaciteti teknik**

### **2.3.1** Përvojë e suksesshme në ekzekutimin e të paktën:

**a-** punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 30 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

**b-** punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se vlera limit e kontratës që prokurohet.

**-Për të vërtetuar përvojen e mëparshme duhet të paraqiten:**

**-Nëse kontrata është realizuar me institucione shtetërore**

1. Formularin e vlerësimit sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
2. Kontratë
3. Situacionin përfundimtar;
4. Aktin e kolaudimit;

**-Nëse kontrata është realizuar me subjekte private:** Formulari i vlerësimit (sipas shtojcës 9) i shoqëruar me:

1. Kontrate;
1. Situacionin përfundimtar;
2. Akt kolaudimi;
3. Fatura tatimore

**Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura për përvojen e suksesshme e bën ofertën të kualifikueshme.**

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenin 55 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.*

*Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht jo më e vogël se 30 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose sa,*

vlera limit e kontratës që prokurohet për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke qene se kjo procedure prokurimi do te konkludoje me nje kontrate pune per te deshmuar pervojen e meparshme vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë sa 30% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë 5 viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës ose punë të ngjashme deri ne nje kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pese viteve të fundit është sa, vlera limit e kontratës që prokurohet.

**2.3.2** Operatorët ekonomike duhet të dëshmojnë **se disponojnë licensë profesionale** për zbatim punimesh në ndërtim si dhe për kategorite e nevojshme për zbatimin e kontratës:

- N.P – 1 A Punime gërmimi në tokë.
- N.P - 7 A Ujësjellës, gazsjellës, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje.

Sipas modelit të lëshuar nga MPPT/MTI/MEI apo Ministria kompetente e linjës.

*Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, pika 1 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar; Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6/a, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

*Klasifikimi i shoqërive ndërtimore sipas niveleve për çdo kategori punimesh zbatimi i referohet Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Kategorite e licenses “N.P” te percaktuara ne piken 2 te kriterave te vecanta te kualifikimit, kapaciteti teknik jane hartuar ne perputhje me zërat konkret të punës që përmban preventivi i punimeve. Me qëllim realizimin e punës objekt prokurimi, është kërkuar që Ofertuesit të jenë të pajisur me Licencë profesionale për këte kategori si dhe të disponojë nënkategoritë sipas gërmave që parashikohen nga legjislacioni përkatës. Përcaktimi i kategorive është vendosur nga mbledhja e vlerave te secilit volum pune, mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, ku janë përcaktuar kategoritë dhe nënkategoritë përkatëse. Kjo kërkesë është vendosur nga Autoriteti Kontraktor me qëllim shqyrtimin e kualifikimit profesional të Ofertuesve në kuadër të veprimtarisë tregtare objekt prokurimi.*

*Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve të këtij objekti, si më poshtë:*

<i>Kategoria e kërkuar</i>	<i>Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës</i>	<i>Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse</i>	<i>Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive</i>	<i>Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse</i>
----------------------------	---	---	--	---

<u>Kategoria</u> <u>NP-1</u>	<i>Punime germimi</i>	<i>1-Punime germime (zerat me nr: 3.45/1</i>	<i>Niveli A</i>	<i>Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr. 42 date 16.01.2008, i ndryshuar</i>
N.P-7	Ujësjiellës, gazsjiellës, vajsjiellës, <b>vepra kullimi e vaditje</b>	<i>Te gjithë zerat e preventivit pasi objektet që do të mirembahen janë vepra kullimi e vaditje</i>	<i>Niveli A</i>	<i>Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr. 42 date 16.01.2008, i ndryshuar</i>

• *N.P-1A Punime germimi ne toke*

*Referuar Preventivit janë parashikuar kryerja e punimeve të gërmimit. Referuar lidhjes 3 të VKM 42/2008 parashikohet se “N.P. 1 Punime gërmimi në tokë Konsiderohen gërmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjete, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gërmohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorishte ose shkëmbore”.*

*-N.P. 7: Referuar lidhjes 3 të VKM 42/2008 parashikohet se “N.P. 7 Ujësjiellës, gazsjiellës, vajsjiellës, vepra kullimi e vaditje Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose rristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshme për realizimin “e shërbimit hidrik kompleks” ose për transportimin në vendet e përdorimit të gazrave, vajrave dhe veprave lidhëse, plotësuese ose ndihmëse edhe në pika të veçanta si edhe në të gjitha impiantet mekanik të nevojshme për të pasur një shërbim të mirë të nevojshëm gjatë përdorimit, funksionimit, informimit, sigurisë dhe asistencës për një funksionim normal. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar veprat e kaptazhit të ujit, impiantet e trajtimit të ujit të pijshëm, ujësjiellësit, kullat e ujit, stacionet e pompimit, depozitat në tokë ose të ngritura, rrjetin shpërndarës deri tek përdoruesi, furnizimi dhe vendosja në vepër e tubacioneve, shkarkimet e ujërave të zeza, si dhe trajtimin e ujërave të përdorura.*

**2.3.3** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- Inxhinier hidroteknik 1 (një)

Për punonjësin e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës noteriale e vlefshme dhe diploma, si dhe duhet të figurojnë në licencën si dhe listëpagesat e shoqërisë për muajin e fundit.

*(Ne rastin e Bashkimit të Operatoreve Ekonomik secili Operator duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt).*

*Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të

Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierin në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Ing hidroteknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve.

**Fushat e Ekspertizes qe mbulojne inxhinierii mesiperm:**

Inxhinier Hidroteknik 1 (një)	- Per ndjekjen e te gjithë zerave ne vepren e ujitje kullimit
-------------------------------	---

**2.3.4** Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar punonjës të kualifikuar dhe te thjeshte, si më poshtë:

- 1 (nje) Teknik Ndertimi
- 6 (gjashte) punonjës pllakashtrues
- 1 (një) punonjes shofer
- 5 (pesë) punonjës të thjeshtë

Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për muajin e fundit.

Per punonjesit e kualifikuar te paraqitet Çertifikatat/diplomat/deshmia te leshuara nga institucione publike/private te licencuara sipas ligjit nr.15/2017 “Per arsimin dhe formimin profesional ne R.SH“, i ndryshuar.

Për teknikun e ndërtimit do të pranohet vetem diploma e shkollës së mesme/licence profesionale nga institucionet përkatëse.

Per shoferin te paraqitet leje drejtimi e vlefshme.

***Nuk do të njihen si dëshmi profesionale kurset e trajnimit të lëshuara nga subjektet të cilat nuk janë të licensuara/akredituara nga institucionet përkatëse për licensimin/akreditimin e tyre.***

*Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.*

***Argumentimi:*** Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Neni 77, pika 4; në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

*Kërkesa specifike për Stafin e punonjësve te specializuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë (kapaciteti teknik në DST). Punëtoret e specializuar (në bashkëpunim me stafin si dhe fuqinë tjetër punëtores) do jetë përgjegjës për të ekzekutuar kontratën objekt prokurimi në zbatim të plotë me Projektin e zbatimit si dhe brenda afatit të parashikuar në Njoftimin e Kontratës.*

*Për sa më lart, gjykohet e arsyeshme që Ofertuesit duhet të kenë punetore të specializuar për betonin, i cili do të garantojë zbatimin e punimeve sipas Specifikimeve teknike dhe do jetë përgjegjës për realizimin e zërave të Preventivit. Referuar VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.*

*Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.*

- 1 (nje) Teknik Ndertimi për të gjithë zerrat e preventivit.
- 6 (gjashtë) punonjës pllakashtrues për të realizuar zerrat e preventivit nr.1.25/p dhe nr. 3.243
- 1 (një) punonjës shofer për drejtimin e mjetit kamion të kerkuar në DST.
- 5 (pesë) punonjës të thjeshtë për të realizuar zerrat e tjere të preventivit.

### **2.3.5 Dëshmi për fuqinë mesatare punëtore të operatorit ekonomik:**

Një punësim mesatar i të paktën **14** (katërbëdhjetë) personave, për muajin e fundit nga data e zhvillimit të tenderit, të vërtetuar me:

1. Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve **për muajin e fundit nga data e zhvillimit të tenderit.**
2. Listpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi **për muajin e fundit nga data e zhvillimit të tenderit** sipas formatit E-Sig 025/a, të konfirmuara nga Administrata Tatimore.

*Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.*

**Argumentimi:** *Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “ç”.*

*Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës.*

*Nga ana teknike argumentojmë se numri mesatar i punonjësve, prej gjithsej 8 punonjësish, është caktuar në bazë të llogaritjeve të zërave të punës dhe volumit përkatës të çdo zëri në preventiv si dhe grafikut në zbatimin të punimeve, të cilat duhet të përfundojnë brenda 1 muaji nga data e nënshkrimit të kontratës, mbështetur kjo në VKM Nr.629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”. Nëpërmjet këtij kushti kërkohet që të vërtetohet se Ofertuesit zotërojnë kapacitetet e nevojshme teknike lidhur me stafin që kanë në dispozicion, si dhe shërbejnë për të provuar se kanë qëndrueshmëri të stafit pa shkëputje nga puna, dëshmi të cilat i japin garancitë e nevojshme Autoritetit Kontraktor mbi përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Numri i punëtorëve si dhe personeli i*

nevojshëm për zbatimin e kontratës është përcaktuar duke marrë në konsideratë vlerën e kontratës që prokurohet, natyrën si dhe kohëzgjatjen e saj si dhe duke u mbështetur mbi përvojën e mëparshme që ka pasur AK në zhvillimin e procedurave me objekt të ngjashëm dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për t'u njohur me kapacitetet profesionale të ofertuesve me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

Gjithashtu për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore si dhe stabilitetin e saj është kërkuar edhe vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve mbështetur edhe në Kreun V, Seksioni III, Neni 39, pika 8 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” sipas së cilës: “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

Llogaritja e oreve të punës për realizimin e punimeve:

Dite pune 8 orarshe në total-ore pune total/ 8 ore në ditë=353

Periudha në ditë për kryerjen e punimeve është 1 muaj=26 ditë pune / muaj \* 1 muaj =26 ditë

Numri i fuqisë punëtore për kryerjen e punimeve për 1 muaj=523 ditë pune total /26

Gjithsej fuqia punëtore e nevojshme për realizimin e kontratës: 14.

**2.3.6** Disponimi ose mundësia e sigurt e disponimit në pajisjet/kapacitetet e mëposhtëme teknike, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës:

Nr.	Lloji i mjetit	Njesia	Sasia	Statusi
1	Kamioncine me kapacitet mbajtes 3.5-7 ton	Cope	1	Ne pronesi ose me qira
2	Betoniere	Cope	1	Ne pronesi ose me qira

a) Për mjetet që regjistrohen në regjistra publike duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikaten e kontrollit teknik, Çertifikatë për transport mallrash për llogari të vetë (vetëm mjetet e transportit) dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), dhe për mjetet e siguruar me qera, dokumentet e mesiperme duhet të shoqërohen me kontratën noteriale përkatëse të qerave, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Për mjetet e transportit me qera të paraqitet gjithashtu Çertifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qira. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të paraqiten aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.



**Argumentimi:** Kërkesa e mesiperme është vendosur sipas pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa ”d” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Nepermjet ketyre kerkesave, Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kanë në dispozicion apo që mund t’u vihen në dispozicion me qellim permbushjen me sukses te kontratës objekt prokurimi.

Nepermjet ketyre kerkesave, Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kanë në dispozicion apo që mund t’u vihen në dispozicion me qellim permbushjen me sukses te kontratës objekt prokurimi.

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zerave te preventivit dhe specifikimeve teknike te hartuara nga projektuesi. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zërave përkatës të Preventivit. Numri i makinerive është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018), si dhe hapësirat fizike rreth objektit mundesive te manovrimit me mjete te renda.

Dokumentacioni shoqëruar i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet Kontratës së Shtitjes apo Kontratës së Qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci Autoritetit Kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të Grafikut të Punimeve (i cili do të publikohet së bashku me Dokumentat e Tenderit).

**Betoniere- sherben per realizimin e zerit me nr.3.243 Struktura monolit betoni C 16/20 si dhe zerin 1.25/p+An.**

**Kamion me kapacitet mbajtes 5 – 10 Ton- sherben per transportimin e tubove te celikut me nr.An.Nr 2 ne preventiv si dhe per transportet e nevojshme te materialeve te tjera.**

**2.3.7** Operatori Ekonomik duhet te disponoje dhe paraqese certifikata te vlefshme:

- SSH/EN-ISO 9001 (Sistemi i menaxhimit të cilësisë) ose ekuivalent
- SSH/EN-ISO 14001 (Sistemi i menaxhimit të mjedisit) ose ekuivalent
- SSH/EN-ISO 45001 (Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë) ose ekuivalent

Certifikatat si më sipër duhet të paraqiten origjinale ose kopje të noterizuara, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Certifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Për vete natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në

*arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pronoen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020 i ndryshuar, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë..*

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike:**

### **Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe Nenit 39, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të Nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

## **NJESIA E PROKURIMIT**